

NJOFTIM PUNE

Balfin Group është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitete për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe manaxhimin e hapësirave tregtare apo industriale, telekomunikacion, industria minerare, financime dhe programe besimi për konsumatorët.

Profili i kompanisë: SPAR Albania është pjesë e Balfin Group dhe drejton rrjetin më të madh të shitjeve ushqimore me pakicë me të drejtën e ekskluzivitetit të emrit "SPAR".

Pozicioni: Menaxher Dyqani

Grada: 8

Departamenti: Operacional

Vendodhja: Tiranë

Përmbledhja e Pozicionit: Të sigurojë nëpërmjet menaxhimit të kostove direkte përfitueshmëri pozitive të dyqanit. Është përgjegjës për mirëmbajtjen e dyqanit, cash-it, blerjet, shërbimin ndaj klientit, etj.

Detyra dhe Përgjegjësi:

- Të mbajë nën kontroll kostot direkte të dyqanit;
- Të supervizojë procesin e porositjes;
- Menaxhim i nivelit të stokut dhe marrja e vendimeve të rëndësishme për kontrollin e stokut;
- Të menaxhojë nëpërmjet sistemit FIFO vendosjen e produkteve në raftet;
- Të respektojë planogramat e caktuara nga Departamentet përkatëse;
- Prezantimi në kohë dhe në kushte sa më optimale të aktiviteteve promovionale;
- Përgjegjësia për cash-in dhe transaksioni i tij në bankë;
- Të motivojë, mbështesë dhe trajtojë stafin e dyqanit duke ofruar siguri teknike të mallrave dhe të njerëzve;
- Të mirëpresë shqetësimet, sugjerimet dhe ankesat e klientëve dhe t'i përcjellë në varësi të problemit tek departamenti përkatës;
- Të sigurojë kushte sa më të mira shitjeje për departamentet e freskëta;
- Kontrollon respektimin dhe aplikimin e standardeve të përcaktuara të higjienës në dyqan;
- Të bashkëpunojë me kolegët dhe klientët për të identifikuar dhe/ose zgjidhur çështjet urgjente.

Kërkesat:

a. Edukimi: Të zotërojë diplomë universitare.

b. Eksperiencat e punës: 3 vite pune në dyqan shitje me pakicë.

c. Kualifikime të tjera:

- Të zotërojë aftësi kompjuterike të paketës Microsoft Office;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze;
- Të ketë marrë pjesë në trajnime në lidhje me menaxhimin, shitjen, etj.

d. Aftësi të tjera:

- Aftësi për të punuar në skuadër;
- Aftësi për të drejtuar, marrë vendime dhe planifikuar;
- Aftësi për të komunikuar me partnerë dhe klientë;
- Aftësi për t'i siguruar klientit një shërbim efikas në çdo situatë.

Kushtet e punës: Ofrohet pagë konkurruese.

Mënyra e aplikimit*: Kandidatët e interesuar janë të lutur të aplikojnë duke dërguar CV-në e tyre së bashku me letër motivimi në adresën e e-mailit hr@spar.al duke përcaktuar në subjekt pozicionin, nëpërmjet faqes së Web-it ose nëpërmjet postës, në adresën: Spar Albania, Tirana East Gate (TEG), Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan, Farkë (Lundër), Tiranë, Shqipëri.

Afati i dorëzimit: 12/02/2020

**Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr .9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrotjen e të Dhënave Personale".*